

Togfjalëshi dhe sintagma

Mr. Agim Spahiu

29 tetor 2002

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori merret me përfaqshjen e termave **TOGFJALËSH** të gjuhësisë shqiptare dhe **SINTAGMË** të gjuhëve të tjera. Dhe, pasi e shqyrton gjerë e gjatë këtë problematikë, duke u mbështetur në të dhëna të shumta që sjell ky autor, qoftë në gjuhësinë tonë qoftë në atë të përgjithshme (botërore), ka ardhur në përfundim se termi TOGFJALËSH është sajuar drejt e sipas rregullave fjalëformuese të shqipes. Prandaj s'ka arsye të mos mbetet edhe më tutje në përdorim. Por ajo që është më me rëndësi këtu është fakti se kjo njësi sintaksore do të duhej të përplotësohej teorikisht nga studimet e gjuhëve të tjera, sidomos nga ato të gjuhës angleze.

Shumë intelektualë, studiues të fushave të ndryshme të dijes, madje edhe gjuhëtarë, në ligjërimin e tyre po ndodh të përdorin termin e huaj sintagmë për termin togfjalësh të shqipes. Madje ka edhe të atillë që në të njëjtin shkrim apo studim e përdorin edhe njërin edhe termin tjetër. Dhe, sigurisht ata asnjëherë nuk e hetojnë ose nuk e shohin ndonjë dallim ekzistues në mes tyre. Pra, i ngatërrojnë, duke menduar se fjala është për dy nocione gjuhësore sinonimike dhe asgjë tjetër. Por çështja nuk është kaq e thjeshtë, ngase fjala është për dy terma gjuhësorë, që duhet të dallohen, në mos për aspektin formal, të paktën për atë konceptual, teorik, përmbajtësor etj. Prandaj, çështja e fundit, apo mosdallimi i tyre nga këto anë, na shtyri t'i qasemi kësaj problematike, kaq komplekse, në këtë shkrim tonin, më qëllim që të ndriçohen disa aspekte të saj.

Si terma sintaksorë, në mes tyre ka, u mor vesh, edhe disa pikëpërkime. Por dallimet në mes tyre, në aspektin përmbajtësor, janë evidente, ngase ata u krijuan pikë së pari në kohë të ndryshme dhe u përdorën nga studiues të rrymave të ndryshe gjuhësore, në vende të ndryshme me sisteme të ndryshme shoqërore-historike etj. Prandaj, si rrjedhojë e gjithë kësaj, në mes tyre nuk duhet dhe nuk bën të vihet përgjithësisht ndonjë vijë barazimi.

Për të mos i pasur këto dilema, në këtë artikull e shohim të udhës që t'i paraqesim disa të dhëna sqaruese me të cilat do të pasqyroheshin të gjitha pikëdallimet ekzistuese në mes tyre:

Termi togfjalësh (për nga fjalëformimi është formuar është ndërtuar nga fjalët *tog+fjalësh*, kjo e fundit në rasën rrjedhore shumë) është sajuar në vitin 1968 nga sintaksologu i njohur shqiptar S. Floqi, i cili për herë të parë, më sa dimë ne, e konceptoi teorikisht

këtë njësi sintaksore dhe e futi në sintaksat e gjuhës shqipe, përgjithësisht¹. Por kjo teori s' ka dyshim se u begatua më vonë nga shumë aspekte të tjera nga studiues të tjerë të shquar, si bie fjala, H. Agani².

Sipas S. Floqit, togfjalëshi është njësi sintaksore strukturore e përfituar nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy a më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, fenomeneve, proceseve e tipareve³.

Nga ky përkufizim del se togfjalësha mund të sajojnë vetëm emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet dhe ndajfoljet, që konsiderohen fjalë kuptimplota; lidhja e fjalëve që sajojnë togfjalësha është nënrenditja (nuk merret parasysh lidhja këtu me bashkërenditje); në togfjalësha mund të shprehen marrëdhëniet: objektore (midis veprimit dhe objektit, si p.sh. *Nis trenin, dëgjoj muzikë* etj.), përcaktore a atributive (si p.sh. *njëqind libra, shirat e vjeshtës, bukë gruri, shkop i thantë* etj.), rrethore (vendore, kohore, shkakore etj.) dhe kallëzuesore a predikative (marrëdhëniet midis bartësit të veprimit a të gjendjes dhe vetë veprimit, si p.sh.: *Ai iku, Hapësira jehonte, Shiu pushoi*); pastaj klasifikimi bëhet gjithnjë duke u mbështetur në gjymtyrën kryesore dhe, sipas kësaj kemi 6 grupe togfjalëshash në gjuhën tonë:

1. Togfjalëshat emërorë,
2. Mbiemërorë,
3. Numërorë,
4. Përemërorë,
5. Foljorë, dhe
6. Ndajfoljorë.

Në këta togfjalësha veprojnë:

- lidhja e përshtatjes,
- e drejtimit,
- e bashkimit, dhe lidhja
- predikative

Nga numri i gjymtyrëve ata ndahen në: **të thjeshtë dhe të zgjeruar. Të thjeshtë** janë të gjitha ata togfjalësha që përbëhen vetëm nga dy fjalë kuptimplota, ndërsa **të zgjeruarit** kanë më shumë se dy fjalë të këtilla.

¹Shih S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1/ 1968, f. 75-84.

²Shih H. Agani, Fjala, nr.1 e 2, 1975, f. 7; Fjala 15.II.1975, f. 7; Fjala, 1.III.1975, f. 7; Fjala 15.III. 1975, f. 7-8, me titull: *Ç' shoh të diskutueshme në Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*.

³Shih Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa e fjalisë I, Prishtinë, 1991; Shih edhe artikullin e lartshënuar të S. Floqit

Këto janë veçoritë më themelore të kësaj njësie sintaksore në vija të përgjithshme, që janë trajtuar në sintaksat e gjuhës shqipe.

Jashtë kësaj teorie të togfjalëshit të konceptuar në këtë mënyrë, siç u tha edhe më lart, kanë mbetur vargjet e fjalëve të bashkuara me bashkërenditje, si p.sh.gurë e misër; grurë, misër e tërëshërë;*mëngjes, drekë, darkë* etj., me arsytim se i përkasin teorisë së gjymtyrëve homogjene të fjalisë dhe jo togfjalëshit⁴, si dhe artikullin e cituar më lart të S. Floqit⁵.

Ky konceptim dhe përkufizim i kësaj njësie gjuhësore e ka mbështetjen përgjithësisht në teorinë gjuhësore të **sllovasaçetanijsë**-s së gjuhës ruse.

Shtrohet pyetja: **Pse pikërisht nga kjo gjuhë?**

Një gjë është e qartë: Metodologjia e punës shkencore-hulumtuese e institucioneve shkencore të Shqipërisë, jo vetëm në fushën e gjuhësisë, në periudhën e sistemit monist mbështetj kryesisht mbi modele të njëjta apo të ngjashme të ish- Bashkimit Sovjetik.Këto metoda ishin të mbështetura kryesisht në materializmin dialektik, të cilat duhej t'i përlligjinin t'i përvijonin studiuesit dhe shkencëtarët e fushave të ndryshme, pra edhe ata të albanologjisë.Kjo ishte arsyeja e parë.Arsyeja e dytë do të ishte edhe kjo: Ish-Bashkimi Sovjetik qysh herët kishte krijuar një plejadë të tërë të studiuesve dhe të shkencëtarëve të cilët kishin dhënë edhe rezultate të çmueshme në të gjitha fushat e dijes, karshi studiuesve perëndimorë etj.

Kështu edhe S.Floqi, në këtë mënyrë, ndonëse i merr për bazë dhe i shqyrton për krahasim barasvlerësit e gjuhëve të tjera që kanë të bëjnë me këtë çështje (si në ang. Word-combination, word-group phrase; frëngj.:group de mot; gjer. Wortgefüge; greq. syntagma etj.) të asaj periudhe, ndonëse sjell edhe disa referenca nga studimet më serioze të asaj kohe e më herët, si p.sh. studimet e F.dë Sosyr-it, të Tenier-it, të Rise-s etj, prapëseprapë teorinë e togfjalëshit në gjuhën shqipe e ndërton kryesisht mbi bazën e studimeve të studiuesve sovjetikë, si Peshkovskij, Vinogradov, Prokopoviç, Belloshapkova, Fjodoruk etj., ndërmjet viteve 1938-1964⁶.

Por studimet e mëvonshme mbi këtë problematikë në gjuhën ruse janë avansuar mjaft, kurse në gjuhën tonë kanë mbetur pothuajse të paprekura.Këtu sa për ilustrim po e sjellim një fakt:derisa në vëllimin **Grammatika russkova jezyka**, vëll. II, pjesa I, të ASH të BRSS- së (redaktuar nga Vinogradovi dhe botuar në Moskë më 1954) togfjalëshat klasifikohen në 6 grupe (ashtu siç i gjejmë të klasifikuar edhe në artikullin e S.Floqit dhe më vonë, pa asnjë ndryshim, edhe në tekstin universitar **Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa e fjalisë**, ose në ndonjë tekst tjetër të R.Përnaskës),në gramatikat e mëvonshme të kësaj gjuhe, si p.sh. në vëllimin **Sovremennyj russkkyj literaturnij jezyk** të një grupi autorësh (redaktuar nga **N.M. Shanskij**⁷ bëhet një përpjekje për t'i klasifikuar drejt togfjalëshat e kësaj gjuhe.Në këtë tekst togfjalëshat janë ndarë në:

1. Togfjalësja foljorë (me fjalën kryesore folje),

⁴Shih tekstin universitar Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, Sintaksa e fjalisë, nga një grup autorësh, ribotuar në Prishtinë më 1991, f.31-58.

⁵Art. i cit., f.75-85.

⁶Shih të dhënat bibliografike të S.Floqit në fund të faqes së parë të artikullit të cituar më lart, f. 75.

⁷Shih tekstin e lartpërmendur,Leningrad,1988,f. 527.

2. Togfjalësja substantivë (me fjalën kryesore emër, përemër emëror, numëror themelor të substantivuar etj.),
3. Togfjalësja mbiemërorë (me fjalën kryesore mbiemër, përemër mbiemëror etj), dhe
4. Togfjalësja ndajfoljorë (me fjalën kryesore ndajfolje)⁸.

Në anën tjetër, termi **sintagmë** ka gjetur një përkufizim shumë më të gjerë në gjuhësi të përgjithshme.

Sipas Sosyr-it, sintagma përbëhet gjithmonë nga dy ose më shumë njësi konsektive, si p. sh.: re- libre, contre tous, la vie humain, dieu est bon; s'il fait beau tamps, nous sortirons etj.

Shembujt e mësipërm na japin të kuptojmë se nocioni sintagmë aplikohet jo vetëm për fjalë, por edhe për grupe fjalësh, për njësi të ndërliqshme gjithfarë dimesionesh dhe gjithfarë lloji (fjalë të përbëra, rrjedhoja, pjesë fjalie, fjali të tëra)⁹.

Ndërkaq A. Martine-ja flet për *sintagmën* dhe *sintagmën autonome*. Sipas tij, sintagma përbëhen çdo kombinim monemash, raportet reciproke të të cilave janë më të ngushta sesa që janë raportet që kanë ato me ekuivalencat e tjera të thënies, plus, eventualisht, monema funksionale që lidh këtë kombinim me pjesën tjetër të thënies¹⁰. Ndërsa **sintagma autonome** është kombinim i dy a më shumë monemave, funksioni i të cilave nuk varet nga vendi i saj në thënie. Mund të jetë i tipit *vitin që shkoi*, ku tërësia e monemave në fjalë e indikon raportin me kontekstin. Por më shumë mban një monemë funksionale (monemat që shërbejnë për ta shënjuar funksionin e një moneme tjetër, p.sh.: pa fjalët: për, me etj. A:S.) që siguron autonominë¹¹. Në këtë kontekst A. Martine-ja dallon sintagmat e ndërliqshme: *me valizhet e mia* dhe *me dëshirën më të madhe*¹².

Në gjuhësinë strukturaliste, **sintagmë** quhet një grup elementesh gjuhësore të cilat sajojnë një njësi brenda një organizimi hierarkik. Fjala sintagmë kurdoherë shoqërohet me një cilësues (përcaktor-, A.S.) i cili ia përcakton kategorinë gramatikore, p.sh.: Gjethi vjeshtor; Ëndrra ime e jetës (Sintagma emërore SE ose nominale) dhe lëkundet, shprishet në bulevard (Sintagma foljore SV)¹³. Këtyre cilësuesve të sintagmave në analizën e mëtejme u bashkohen edhe cilësues të tjerë, siç janë: sintagma parafjalore, mbiemërore¹⁴ etj. Sipas kësaj del se **sintagmë** konsiderohet: *një fjalë e vetme dhe një fjalë së bashku me përcaktorë të vet*. P.sh. sintagma emërore kurdoherë paraqitet si tërësi e përbërë prej një emri dhe një determinativi që i takon kësaj paradigme: **SE—Det + E**, ku si determinues a përcaktues mund të jetë nyja e prapme, referencë e kategorisë gramatikore të rasës ose përcaktues, që mund të hyjnë ose të injektohen në po atë segment paradigmatic; p.sh.: E= vëlla; D=/-i; D=/-në; D=/-një (pra: një vëlla); D=/ky (pra: ky vëlla); D=/- im (pra: im vëlla)¹⁵. etj. Po kështu, në fjalinë: **Fëmija po DEL**, segmenti po **DEL** merret

⁸Shih për të gjitha këto veprën e cituar f. 527.

⁹Shih F.dë sosyr, Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, Prishtinë, 1977, f. 197-199.

¹⁰Shih A, Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 156-157.

¹¹Po aty, f. 157.

¹²Po aty, f. 157.

¹³Shih A.Hajdari, *Doracak i gjuhësisë*, Shkup, 1988, f. 39

¹⁴Po aty, f. 39

¹⁵Po aty, f. 90.

edhe si sintagmë foljore edhe si folje, që e përbën këtë sintagmë. Por në fjalinë: Bagëtia e di rrugën dhe : Drita ha një mollë, grupet e segmenteve: **e di rrugën** dhe **ha një mollë** konsiderohen si sintagma foljore të sajuara nga foljet di dhe zgjerimit të tyre, siç është sintagma emërore në funksionin e plotësit kundrinor,-kundrinë e drejtë (plotës i veprimit të vepruesit)¹⁶.

Sipas D. **Kristel**-it, sintagma (Phrase) është term i analizës gramatikore i cili shënon elementet e një strukture që përmban më shumë se një fjalë, por që nuk e ka strukturën SUBJEKT-PREDIKAT, karakteristikë për klauzën. Vendoset në mes klauzës dhe fjalës. Dallohen disa lloje sintagmash: **sintagmat ndajfoljore** (p.sh. herët në mëngjes...), **sintagmat mbiemërore** (p.sh.: shtëpia e vjetër dhe e rrënuar), **sintagmat parafjalore** (p.sh. në këtë moment...)¹⁷.

Ngjashëm me D. Kristel-in këtë njësi e përkufizon edhe **R. Bugarski**. Sintagma, sipas tij përbën grupin prej dy a më shumë fjalësh të lidhura gramatikisht të cilat vetë nuk e shprehin predikativitetin (lidhjen e subjektit me predikatin), por marrin pjesë në strukturën e njësisive më të mëdha. Duke u mbështetur në llojet e fjalëve që përbëjnë dhe të karakterit të raporteve të tyre, sintagmat, edhe ky gjuhëtar i ndan në: emërore (p.sh. vajzë e re, kafe e çaj), foljore (p.sh. do të vij, të shkruash letër), mbiemërore (p.sh. shumë e re, i pasur me njohuri), ndajfoljore (p.sh. shumë më ngadalë), parafjalore (p.sh. në tavolinë, mbi të gjitha)¹⁸.

N. Çomski (Noam Chomsky) në shqyrtimet e tij teorike gjenerativiste e përdor termin **phrase** për analogji me termin **sintagmë**. Sipas tij, sentenca (me kuptimin e fjalisë-nënvizim imi-A.S.) përgjithësisht mund të zbërthehet në një frazë nominale dhe në një frazë verbale. Frazja nominale zbërthehet në: njëj dhe në emër, ndërsa fraza verbale në: folje dhe në frazë nominale, e paraqitur me këto simbole: Sentece——NP+NP (The man hit the ball), NP———T+N (The man), VP———Verb+NP (hit+the ball)¹⁹. Nga kjo del se vetëm në kuadër të këtyre dy frazave që janë më kryesoret, dalin frazat e tjera, çka do të thotë se të tjerat varen nga këto dy fraza mbizotëruese.

Edhe gramatikanët frankofonë në deceniet e fundit i janë shmangur termit sintagmë. Ata kryesisht po e përdorin emërtimin group du mots. Por, ka ndonjë që e përdor edhe termin sintagmë, si p.sh. **O. Soutet** në studimin e tij *La syntaxe du française*, botuar më 1989 në Paris. Sipas **O. Soutet**-it, morfema njëj e sintagmës nominale është vetë leksema nominale me disa determinantë, si p.sh. le garçon, le petit garçon, le garçon qui mange son gouter, etj.; morfema njëj e sintagmës mbiemërore (SA)/adjektivale/ është një leksemë mbiemërore, eventualisht, së bashku me një leksemë ndajfoljore dhe/ ose një sintagmë parafjalore (prepositionnel), p.sh. fier, tres fier, tres fier de sa reussite etj.; morfema njëj e sintagmës parafjalore (SP) është një parafjalë ose një lokucion parafjalor që bashkohet me një SN, p.sh. malgre cette decision, compte tenu de cette decision etj.; dhe morfema njëj e sintagmës foljore (SV) është vetë leksema foljore, eventualisht e bashkuar me një SN ose SP, p.sh. (Pierre) dort, mange de gateaux, profite de ses vacances ²⁰etj.

¹⁶Po aty, f. 104.

¹⁷Shih D. Kristel, *Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike*, Beograd, f. 235

¹⁸Shih R. Bugarski, *Uvod u opstu lingvistiku*, Beograd, 1991, f. 117.

¹⁹Shih N. Comski, *Sintaksicke strukture*, Beograd, 1984, f. 35-37.

²⁰Shih O. Soutet, *La syntaxe du française*, Paris, 1989, f. 11.

Këto janë disa të dhëna të mjaftueshme për të ardhur në një përfundim se në trajtimin teorik togfjalëshit dhe sintagmës ekzistojnë disa dallime në mes shqipes e gjuhëve të tjera të përmendura perëndimore. Ato si nocione gjuhësore mund të ndërëmbëhen, por shpjegimet e deritashme në aspektin teorik janë bërë mbi bazën e kriterve të ndryshme. Dallime e inkonsekuenca ka, siç u pa, edhe për vetë termin sintagmë, që dalin nga studimet e së njëjtës gjuhë, ngase, sikundër dihet, këtu kemi të bëjmë me qasje të ndryshme metodologjike, në periudha të ndryshme kohore etj.

Sa i përket gjuhës sonë, ne mendojmë se edhe më tutje është mirë të përdoret termi togfjalësh, ngase është një sajesë e gatitur mjaft mirë. Por sa i përket përkufizimit, kjo njësi sintaksore ka nevojë të ripërkufizohet dhe të plotësohet me disa të dhëna të tjera që aty-këtu u përmenden në disa vepra të gjuhësisë së përgjithshme dhe në disa gramatika më të avansuara të gjuhëve botërore, mirëpo gjithnjë duke i pasur parasysh specifikat e gjuhës sonë.

Lidhur me këtë çështje, ne do të parapëlqenim më shumë modelin e gjuhës angleze në përkufizimin e termit **phrase** në gramatikat e decenieve të fundit.

Duke u mbështetur në modelin e disa gramatikave të avansuara shkencore të kësaj gjuhe, edhe ne në gjuhën tonë do të duhej të kishim: Togfjalësja emërorë, 2)mbiemërorë, 3)foljorë, 4)ndajfoljorë dhe 5)parafjalorë. Jashtë këtij klasifikimi mbesin togfjalëshat përemërorë dhe numërorë, ngase, me të drejtë, ata do të duhej t'i takonin grupit të togfjalëshave emërorë (meqenëse disa përemra zëvendësojnë emrat, ndërsa numërorët kur janë të emëruar, i kanë të gjitha kategoritë gramatikore të emrit dhe faktikisht mund të konsiderohen si emra), ndërsa këtij grupi i shtohen edhe togfjalëshat parafjalorë, (te këta të fundit nuk kemi dy fjalë kuptimplote, siç e kërkonte teoria e deritashme për të sajuar togfjalësh).

Edhe këta togfjalësja, për nga ana strukturore, do të ndahen në:

1. Togfjalësja të thjeshtë ose me strukturë minimale, dhe
2. Togfjalësja të përbërë ose me strukturë komplekse.

Togfjalëshat e thjeshtë ose me strukturë minimale përbëhen nga fjalët drejtuese që kanë morfema gramatikore (p.sh.mbaresat me të cilat shprehen kuptimet gramatikore të rasës e të shquarësisë a të joshquarësisë tek emri, të gjinisë e të numrit të mbiemri dhe të kohës, të vetës, të numrit e pjesërisht të diatezës të folja;nyjat e pacaktuara e të përparme, ndajshatesat fjalëformuese). Këto vlejné, pra, vetëm për emrat, mbiemrat dhe foljet që i nënshtrohen eptimit. Kurse nuk vlejné për ndajfoljet e parme (p.sh.mirë, keq, lart, poshtë, bukur; sot, sonte, këtu, atje etj.), të cilat nuk i kanë kategoritë e përmendura gramatikore dhe sot konsiderohen si të pazbërthyeshme (ndonëse disa prej tyre historikisht mund të zbërthehen në dy a më shumë pjesë, si: sot < *so dite/këso dite; sonte < *so nate/ këso nate). Pra, sipas kësaj del se çdo emër, mbiemër a folje me morfemat e veta gramatikore, mund të konsiderohen edhe togfjalësh i thjeshtë ose togfjalësh me strukturë minimale. Kurse togfjalëshat parafjalor, sikundër u tha edhe më lart, përbëhen nga parafjalët që janë bërthama a *nukleusi* kryesor i këtyre togfjalëshave, plus një trajtë emërore që njëkohësisht mund të konsiderohen edhe si togfjalësh emëror. E tëra kjo mund të zbërthehet edhe me anë të një shembulli, duke e zbërthyer fjalinë: Agroni i vogël punon

shpejt me kompjuter. Nga ky shembull kemi: *Agroni*-si togfjalësh i thjeshtë emëror; *i vogël*-si togfjalësh mbiemëror;*punon* - togfjalësh foljor; *shpejt*- togfjalësh ndajfoljor;dhe *me kompjuter* -togfjalësh parafjalor.

Ndërkaq **togfjalëshat e përbërë a me strukturë komplekse**, që, për mendimin tonë, janë togfjalësha të vërtetë, formohen nga fjalët drejtuese dhe nga modifikatorët, të cilët, varësisht nga pozita e tyre, mund të ndahen në: premodifikatorë dhe në postmodifikatorë.Këta modifikatorë janë gjymtyrë të cilat varen nga fjalët e tyre drejtuese, ndërsa togfjalëshat e formuar me ta konsiderohen endocentrikë.

Kështu p.sh. te **togfjalëshat emërorë** (fjalë drejtuese mund të jetë emri, mbiemri i substantivuar, përemrat vetorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar dhe të gjithë përemrat që mund t'i zëvendësojnë emrat dhe që i kanë kategoritë gramatikore të tyre; pastaj numërorët dhe rreshtorët e substantivuar dhe çdo fjalë tjetër që mund të substantivohet) premodifikatorë mund të jenë të gjithë përcaktorët me prejardhje përemërore dhe numërore, kurse postmodifikatorë mund të jenë: një emër në gjinore, kallëzore e rrjedhore pa parafjalë dhe në emërore, në kallëzore e në rrjedhore me parafjalë;disa përcaktorë me përshtatje me prejardhje përemërore e numërore; disa përcaktorë të papërshtatur me prejardhje ndajfoljore, pjesore të zgjeruara (sip.sh. dy kalorës, *hipur mbi kua*...), paskajore dhe përcjellore (si p.sh.:dëshira *për të studiuar*...; boksieri, *duke e ndjekur me sy të nxirë*...),disa ndërtime frazeologjike(si p.sh.:E kishte ndërtuar një shtëpi *për kokë të shtëpisë*.),madje edhe një nënfjali përcaktore lidhore e lidhëzore (p.sh.: Njeriu *që vetëm për vete punon*,...; Lajmi *se do të shpërndahet misri*,...), pastaj ndajshtimi i paveçuar dhe i veçuar (si p.sh.:*profesor Agroni/ ne studentët, ju fëmijët/; Djali i madh i Aliut, Agroni*...) etj.

Te **togfjalëshat foljorë** si premodifikatorë na dalin foljet ndihmëse kam e jam (që formojnë kështu kohët e shkuara analitike); pjesëzat: do të të cilat formojnë kohë të ardhme të dëftores dhe të gjitha kohët e lidhore;pjesëzat mohuese: nuk, s', mos; folja këpujore jam;foljet gjysmëndihmëse modale:mund, duhet, do; foljet aspekte: zë, nis, filloj, marr, bëj, vazhdoj, vijo, mbaroj etj.; në ndonjë rast edhe ndonjë nënfjali e tërë ftilluese e rrethanore (si p.sh.: Se ç'kishin bërë, ustai e mori me mend; Ku ta dërgoje, atje shkonte).Ndërsa, në anën tjetër, si postmodifikatorë mund të dalin të gjitha trajtat emërore me dhe pa parafjalë;disa trajta përemërore, sidomos ato prejfoljore; ndajfoljet e mënyrës e të sasisë; trajtat e pashtjelluara; në mjaft raste edhe nënfjalitë ftilluese, por edhe rrethanore (si p.sh.:S'dihet se kur mbaroi kjo punë /S'e di se kur mbaroj kjo punë; U shtir sikur të ishte i vdekur; Iku që të mos kthehej më; Më njoftoni nëse ai vjen etj.), ndonjë ndërtim frazeologjik(p.sh.:U zhduk sa hap e mbyll sytë) etj.

Te **togfjalëshat mbiemërorë** më së shpeshti si premodifikatorë mund të dalin ndajfoljet dhe lokucionet ndajfoljore (p.sh.:shumë i ditur, mjaft i mirë, jashtëzakonisht i rëndë, gjithmonë i pakënaqur; dikur i fort, tani i kërrusur, aq i vërytshëm, sa...; etj.Kurse si postmodifikatorë mund të dalin trajtat emërore me dhe pa parafjalë (si p.sh.: E kuqe si molla, e bardhë si bora, e ftohtë si akulli, e lodhur nga rruga, i mahnitur nga bukuria e saj, i aftë në matematikë; etj.);paskajoret (si.sh.: i gatshëm për t'u ballafaquar me vështirësitë e jetës;); edhe ndonjë nënfjali rrethanore (si p.sh.: Të bindur (= pasi ishin të bindur)se një veprim i tillë do të kishte pasoja për të sëmurin, doktorët morën një varg masash për t'ia shpëtuar jetën të sëmurit; Ajo ishte e lumtur, ngase e kishte kryer punën

me nder; I biri, Gjon Kastrioti, ishte tepër i vogël që të vihej në krye të Ligës; etj.

Te **togfjalëshat ndajfoljorë** premodifikatorë mund të jenë vetëm ndajfoljet, si: mjaft, shumë, tepër, jashtëzakonisht etj., me ndajfoljet e tjera (p.sh.: mjaft mirë, shumë larg, tepër ngadalë, jashtëzakonisht poshtë)etj.; pastaj togu: numëror themelor+ emri herë (p.sh.: dy herë më pak, tri herë më shumë) që mund të konsiderohen si togfjalësha.Ndërsa si postmodifikatorë mund të jenë trajtat emërore me parafjalë, të cilat përbëjnë togfjalësha parafjalor (p.sh.: sot pas dreke, nesër në mëngjes, diku në themelet, aty në borë etj), si dhe ndonjë nënfjali e tërë (p.sh.:Më mirë të vdesësh sesa të rrosh në pranga; Ai, edhe sikur të punojë, më shumë se ç' merrte, nuk mund të marrë; Sepse ndryshe nga ç' mendohej gjer tani, puna paskish shkuar tepër larg;) etj.

Dhe, së fundi, **togfjalëshat parafjalorë** në gjuhën shqipe kanë vetëm postmodifikatorë.Premodifikatorë mund të ketë (mund t'i paravihen rregullisht trajtave emërore apo foljore), por, në raport me to, togfjalëshat parafjalorë mbeten gjymtyrë të varura të tyre. Pra, vetë mbeten postmodifikatorë (p.sh.: te ndërtimi: lis me degë të gjera, togfjalëshi me degë të gjera e përcakton emrin lis.Kurse te ndërtimi: shkruaj me makinë, togfjalëshi me makinë është në raportin objektor me foljen shkruaj, prandaj është gjymtyrë e nënrenditur nga folja.Prandaj edhe lokucionet parafjalore janë gjymtyrë kryesore, ngaqë me reksionin e tyre, varësisht sipas rasave, mund të drejtojnë dhe të marrin një a më shumë gjymtyrë të varura. Gjymtyrë të tyre të varura a postmodifikatorë mund të jenë: një emër, një mbiemër të substantivuar në rasën emërore me parafjalët: nga, te/tek; në rasën gjinore me lokucionet parafjalore: me anë (të), nga ana (e), në fushën (e), në saje (të),për shkak (të), në drejtim (të), për arsye (të), etj.;në rasën kallëzore me parafjalët dhe lokucionet parafjalore: në, me, për, pa, më, mbi, nën, ndër, nëpër, , bashkë me, tok me, në krahasim me, në lidhje me etj.;dhe në rasën rrjedhore me parafjalët: prej, ndaj, për, anë, majë, buzë, afër, përveç, sipas etj.

Ndërtimi parafjalë+ emër, siç u tha edhe më lart, përbën togfjalëshin parafjalor me strukturë minimale a të thjeshtë.Ndërsa ka strukturë të përbërë a komplekse kur trajtës emërore i paravihet edhe ndonjë trajtë tjetër emërore, mbiemërore, ndajfoljore etj.(p.sh.:në qytetin e Prishtinës, në kopshtin e bukur/me lule, prej pyllit matanë,...),me vlerë përcaktore.

Togfjalëshi i thjeshtë dhe i përbërë parafjalor mund të lidhet, po ashtu, drejtpërsëdrejti edhe me një *nënfjali përcaktore* (p.sh.: në javën që vjen...,në dhomën ku ndodheshin mysafirët...; prej momentit kur ndodhi ajo ngjarje...;Me teknikën që e kemi në dispozicion, nuk mund të arrijmë shumë; etj.

Premodifikatorët dhe posmodifikatorët e këtyre togfjalëshave, sipas kësaj teorie gjuhësore, mund të jenë edhe më të shumtë dhe me strukturë më të larmishme.Por ne këtu i regjistruam vetëm disa raste, duke mos pasur mundësi të bëjmë ndonjë inventarizim më të plotë, për shkak të natyrës së punimit.

Nga klasifikimet e përgjithshme të togfjalëshave del se togfjalëshat emërorë dhe foljorë janë më kryesorët në njësitë kumtuuese , ndërsa togfjalëshat mbiemërorë, ndajfoljorë dhe parafjalorë janë në shërbim të tyre dhe mund të konsiderohen, në njëfarë mënyrë, si nëntogfjalësha.

Si togfjalësha duhet të merren edhe ndërtimet me bashkërenditje të cilat janë mohuar në gramatikat tona, pasi që edhe ato si vargje e kanë kuptimin dhe mëvetësinë e tyre

leksikore, pavarësisht nga ajo se në analizën gramatikore e kanë funksionin e njëjtë në njësitë sintaksore, pra janë gjymtyrë homogjene (p.sh.: libri dhe fletorja...; shkruan dhe lexon; fillon e fryn; njeri i sjellshëm e punëtor...; shpejt e mirë; në fshat e në qytet; për dhe kundër kësaj etj.), madje edhe vetë fjalitë me bashkërenditje, të gjitha këto si ndërtime ekzocentrike.

Literatura plotësuese: D.Blaganje,I.Konnte, *Modern english grammar*, Ljubljana, 1979; O.Buhholz, W.Fiedler, *Albanische Grammatik*, Leipzig, 1987, f. 407/408 dhe 413-427; P. Guiraud, *La syntaxe du français*, Paris, 1967, f. 77; O.Soutet, *La syntaxe du française*, Paris, 1989, f. 11; Grevisse, Goosse, *Nouvelle grammaire française*, Ducolot, 1995 etj.